Komuna e Deçanit | Datë: 15.07.2025

RAPORT I DËGJIMIT BUXHETOR PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB)

Më 19 qershor 2025, në sallën e Kuvendit Komunal, u mbajt dëgjimi buxhetor me qytetarët, përfaqësuesit e këshillave të fshatrave si dhe përfaqësues të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë, në kuadër të përgatitjeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2026.

Takimi u hap dhe u udhëhoq nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Hajdar Sutaj. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, si dhe Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, bashkë me drejtorë të tjerë të drejtorive dhe anëtarë të grupit punues për buxhet.

Hapja e takimit

Kryesuesi z. Hajdar Sutaj, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi rëndësinë e këtij procesi, i cili përbën një pjesë të domosdoshme të transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së publikut në procesin e hartimit të buxhetit komunal. Ai sqaroi se dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë edhe në muajt korrik dhe gusht në lokalitetet e tjera të komunës dhe se të gjitha kërkesat që do të paraqiten nga qytetarët do të evidentohen në procesverbal.

Prezantimi i buxhetit

Më pas, fjala iu dha Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, e cila prezantoi Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028. Bazuar në qarkoren buxhetore të Ministrisë së Financave 2026/01, buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2026 do të ketë ulje si pasoje e rënies se popullsisë bazuar ne regjistrimin e fundit te ASK-se te vitit 2024, mirëpo Ministria e Financave për vitin 2026 ka marre përsipër qe te mbuloj minusin e krijuar për komunat te cilat kane rënie te numrit te popullsisë. Ajo paraqiti ndarjen e buxhetit sipas kategorive ekonomike dhe theksoi se buxheti i propozuar për vitin 2026 është më i ulët afërsisht për 100,000 euro krahasuar me vitin 2025.

Ajo shtjelloi ndarjet buxhetore për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

Për vitin 2026 grandi i përgjithshëm është 6,723,133.00

Grandi specifik i arsimit është 4,968,221.00

Grandi specifik për Shëndetësi është 1,692,341.00

Shërbime rezidenciale janë 200,000.00

Ne total i bie 13,583,695.00

Te hyrat vetanake parashihet te jene 968,279.00

Totali i buxhetit për vitin 2026 parashihet te jete **14,551,974.00**

Për vitin 2027 buxheti parashihet te jete 14,413,973.00

Për vitin 2028 buxheti parashihet te jete 13,530,758.00

Sipas planifikimit te KAB-it Komuna e Deçanit ka planifikuar qe buxhetin ne vlere prej 14,551,974.00 ta ndaj ne kategoritë si me poshtë:

- Paga dhe mëditje 8,921,380.00
- Mallra dhe shërbime 2,000,000.00
- Shpenzime komunale 300,000.00
- Subvencione dhe transfere 350,000.00
- Investime kapitale 2,980,594.00

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuara dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	**Kërkesat / Sugjerimet / Komentet**	**Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023**	**Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar**	**Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)**
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026	Beqir Kuçi falënderoi kryetarin dhe stafin komunal për punën e bërë në Deçan. Gjithashtu, ai kërkoi që të punohet për sistemin e kanalizimit në lagjet e	Gjylsha Hakaj kërkoi që të ketë rritje të buxhetit për Drejtorinë e Arsimit		

	qytetit të Deçanit. Në përgjigje, drejtoresha për Buxhet znj. Dafina Cacaj sqaroi se ky proces tashmë është në procedurë të tenderimit.			

Pjesëmarrja dhe dokumentimi

Në këtë dëgjim morën pjesë gjithsej 44 qytetarë, prej tyre 11 gra dhe 33 burra. Pjesëmarrja është dëshmuar përmes listave të nënshkrimeve të pjesëmarrësve.

Rreth njoftimeve

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore në faqen zyrtare të Komunës së Deçanit dhe në platformën për konsultime publike, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ. Njoftimet janë shpërndarë gjithashtu përmes rrjeteve sociale facebook, webfaqe, si dhe janë komunikuar me kohë me punonjësit e sektorit të shëndetësisë, arsimit dhe këshillat e fshatrave.

Publikuar në webfaqe: 09.06.2025

https://decan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftim-Publik-09.06.2025.pdf

Publikimi për Facebook: 09.06.2025

https://www.facebook.com/photo/?fbid=1277553667713872&set=a.324214523047796

Qëllimi i këtij procesi është rritja e përfshirjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit dhe forcimi i transparencës institucionale në nivel lokal.

Zyra për Informim
Edone Kameraj

Kameraj

Z. Kyetarit 18032
02 17.07.25